



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 419/7 Prot.

Tiranë, më 2/9/2015

REKOMANDIM

Nr. 34 / datë 02/9 /2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, pas kontrollit të ushtruar në ngarkim të kontrolluesit "Tranzit sh.p.k",

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 137, datë 08/06/2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Tranzit sh.p.k. me objekt:

- Zbatim nga ana e kontrolluesit i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

Kontrolluesi "Tranzit sh.p.k" (Nipt: K91624020M) është institucion financiar jo bankë i përqëndruar në kredidhënie me terma fleksibël për shoqëri (persona juridikë) dhe individë (persona fizikë). Paketat e financimit dhe produktet që ofron përfshijnë kredi, pjesëmarrje direkte në kapital dhe blerje borxhesh. Tranzit është shoqëri e fondeve investuese të administruara nga NCH Capital. Tranzit është licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar aktivitetin si Institucion Financiar Jo Banke në vitin 2010. Për arsye objektive, kontrolluesi deri më tani ka ofruar vetëm dy nga produktet, "Kredi financiare" dhe "Blerje dhe financim borxhesh".

Hetimi administrativ nga Zyra e Komisionerit u iniciua mbi bazën e një ankese të bërë nëpërmjet faqes zyrtare të Komisionerit info@idp.al.

Nëpërmjet ankesës pretendohet se kontrolluesi ka të dhënat e të gjithë shtetasve që kanë kredi të këqija të cilat i kanë blerë nga bankat. Sipas palës ankuese, të dhënat përdoren në gjithfarë mënyrash për tu bërë presion njerëzve me anë të palëve të treta ose direkt.

Zyra e Komisionerit pas kryerjes së veprimeve hetimore administrative në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, vlerëson se pretendimet e palës ankuese nuk janë të bazuara në fakte dhe në prova. Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të ofrimit të shërbimit "Blerje dhe financim borxhesh" është i ligjshëm, i sanksionuar

nëpërmjet “Kontratës për kalimin e kredisë” dhe garanton të drejtat e subjekteve të të dhënave personale (klientëve).

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi “Tranzit shpk” mbledh dhe përpunon të dhëna personale në rrjetin e brendshëm kompjuterik nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit. Programi kryesor informatik përmes të cilit kontrolluesi përpunon të dhënat e klientëve të tij është “Matrix Collection” (një sistem informatik për menaxhimin e borxheve). Kontrolluesi ka lidhur një marrëveshje konsulence dhe mirëmbajtje për rrjetin, programet dhe pajisjet *hardware* ku parashikohet në një nen të veçantë konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale.

Kontrolluesi ka marrë masat teknike të veçanta në kuadër të sigurisë së këtij sistemi dhe të dhënave që përpunohen përmes tij:

- Mbajtja e programit dhe bazës së të dhënave në një server të izoluar nga rrjeti i jashtëm (interneti)
- Mbrojtja e rrjetit të brendshëm me sisteme *software* dhe *hardware* (antivirus/*firewall*)
- Mbajtje e informacionit të dubluar në dy servera të vendosur për arsye sigurie në dy adresa të ndryshme.
- *Backup* periodik të databazës.
- Rregullore e brendshme, ku përcaktohet aksesit i kufizuar në program.
- Asistence, trajnim për personelin që përdor programin.

Të dhënat e punonjësve ruhen në ambiente të sigurta dhe aksesit në to është i kufizuar vetëm për disa persona. Dokumentet administrohen në dosjen personale të punonjësit në përputhje me kodin e punës.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887, dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi, Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në procesverbalin e hetimit (datë 09.07.2015), konstatoi se:

1. Në kuadër të zbatimit të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, nga verifikimi i njoftimit të kontrolluesit, rezultoi se, nuk është përditësuar përmbajtja e njoftimit me ndryshimet që kanë ndodhur në përpunimin e të dhënave përsa i përket deklaramit, si më poshtë:
 - “Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen” (rubrika 3), u konstatua se kontrolluesi përpunon të dhëna për kategori të tjera nga ato të deklaruara fillimisht, si për garantorët, pjestarët e familjes bashkëshortin/bashkëshorten dhe fëmijët e klientit.
 - “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen” (rubrika 4), u konstatua se kontrolluesi përpunon të dhëna mbi statusin civil, nr. tel., e-mail, çertifikata pronësie.
 - “Marrësit e të dhënave personale” (rubrika 7), u konstatua se kontrolluesi kryen përhapje të dhënash drejt subjekteve të tjera kontrolluese të cilat nuk janë deklaruar në njoftimin fillestar, gjithashtu nuk është kryer deklarata e ndryshimit

në lidhje me përhapjen e cila nuk realizohet më drejt dy subjekteve kontrolluese. Ndryshimet e ndodhura duhet të shoqërohen me plotësim të qëllimit të përhapjes apo transmetimit.

2. Kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimin e parashikuar në nenin 18/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, sa i përket:
 - Informimit të klientëve (në cilësinë e subjektit të të dhënave personale) nëpërmjet “Formularit të aplikimit për kredi” dhe “Formateve të Kontratave”, lidhur me mënyrën e përpunimit dhe të drejtat që gëzojnë në kuadër të ligjit për mbrojtjen e të dhënave;
 - Informimit të punonjësve (në cilësinë e subjektit të të dhënave personale) lidhur me fushën dhe qëllimin, për të cilin përpunohen të dhënat personale, personin që do ti përpunojë të dhënat, mënyrën e përpunimit dhe të drejtat që gëzojnë në kuadër të ligjit për mbrojtjen e të dhënave;
 - Publikimit të “politikave të privatësisë” në faqen/ëeb-sitin (ëëë.tranzit.com.al) të administruar prej tij, me qëllim informimin e çdo personi që viziton faqen (subjekt i të dhënave personale ose jo), mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, masat e marra për sigurinë e të dhënave personale si dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Në këtë kuadër subjektet e të dhënave janë privuar nga e drejta për informim;
3. Kontrolluesi, në aktet e brendshme organizative, aktet që sanksionojnë marrëdhënien me punonjësit dhe aktet lidhur me rregullat e përpunimit të të dhënave personale, nuk ka parashikuar një afat konkret lidhur me mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale të punonjësve (të administruara në dosjet e punës nga burimet njerëzore), pas përfundimit të marrëdhënies së punës, në kundërshtim të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08/09/2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”;
4. Klienti nuk është informuar mbi afatin e mbajtjes së të dhënave të tij personale, pas përfundimit të marrëdhënies kontraktore me kontrolluesin (pas shlyerjes së kredisë) në kundërshtim të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
5. Në kuadër të zbatimit të nenit 27 të ligjit nr. 9887 dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar:
 - Kontrolluesi nuk ka hartuar rregulla lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video-survejimit;
 - Tabelat informuese për kamerat nuk janë hartuar sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin nr. 3, pasi nuk e informojnë subjektin e të dhënave mbi mundësinë e

ushtrimit të të drejtave të tyre të sanksionuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe nuk i jep mundësinë për të kontaktuar me kontrolluesin nëpërmjet numrit të telefonit;

Në lidhje me këto konstatime kontrolluesi ka paraqitur pretendimet dhe dokumentet përkatëse nëpërmjet shkresës nr. 62/15 prot, datë 13.07.2015. Gjithashtu janë paraqitur dokumente mbi masat e marra nga kontrolluesi edhe në seancën dëgjimore të datës 21.07.2015. Seanca dëgjimore është realizuar nga Zyra e Komisionerit në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Zyra e Komisionerit, pasi analizoi pretendimet dhe dokumentet e paraqitura nga kontrolluesi vlerëson se:

- Janë marrë masa sa i përket përditësimit të formularit të njoftimit në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Në këtë kuadër është dorëzuar formulari i njoftimit me ndryshimet përkatëse;
- Janë ndërmarrë hapa konkretë në kuadër të respektimit të detyrimeve të parashikuara në nenin 18/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Në këtë kuadër kontrolluesi ka përgatitur ndryshimet përkatëse në “Formularin e aplikimit për kredi”, “Kontratën e huasë tip”, “Kontratën e Hipotekës tip” dhe Kontratën e Punës tip”. Nga analizimi i tyre rezulton se informimi nuk është i plotë dhe në to nuk janë përfshirë dispozita mbi të drejtat që gëzojnë subjektet e të dhënave personale (klientë, punonjës) në kuadër të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Zyra e Komisionerit thekson se njohja e subjekteve të të dhënave me të drejtat që gëzojnë, garanton ushtrimin real të tyre.

Nga analizimi i përmbajtjes së “Politikës së privatësisë” Zyra e Komisionerit konstaton se nuk është gjithëpërfshirëse por fokusohet vetëm në të dhënat që përpunohen nëpërmjet faqes Web (online). Në këtë kuadër është e rëndësishme që të kuptohet se roli informues i “Politikave të privatësisë” duhet të përfshijë çdo kategori të dhëne personale dhe çdo subjekt të të dhënave, pra qoftë për të dhënat që përpunohen manualisht qoftë për ato që përpunohen elektronikisht.

- Kontrolluesi, në “Rregulloren e Brendshme” dhe “Kontratën e Punës tip” që sanksionon marrëdhënien me punonjësit ka parashikuar një afat konkret prej tre vitesh, lidhur me mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale të punonjësve (të administruara në dosjet e punës nga burimet njerëzore), pas përfundimit të marrëdhënies së punës, në kuadër të respektimit të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08/09/2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”;

Nga analizimi i akteve rezulton që nuk është përcaktuar qëllimi i mbajtjes së të dhënave të punonjësve pas përfundimit të marrëdhënies së punës por është parashikuar qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Informimi mbi qëllimin e mbajtjes së të dhënave është i rëndësishëm në kuadër të transparencës së kontrolluesit.

- Kontrolluesi, në "Rregulloren e Brendshme", "Formularin e aplikimit për kredi", "Kontratën e huasë tip" dhe "Kontratën e Hipotekës tip", ka parashikuar një afat konkret prej pesë vitesh, lidhur me mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale të klientëve (të administruara në dosjet e klientëve), në kuadër të respektimit të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Edhe në këtë rast rezulton që nuk është përcaktuar qëllimi i mbajtjes së të dhënave të klientëve pas përfundimit të marrëdhënies kontraktore por është parashikuar qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Informimi mbi qëllimin e mbajtjes së të dhënave është i rëndësishëm në kuadër të transparencës së kontrolluesit.

- Në kuadër të zbatimit të nenit 27 të ligjit nr. 9887 dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar, kontrolluesi ka përgatitur "tabelën informuese për kamerat" sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin nr. 3 dhe gjithashtu ka parashikuar dispozita konkrete lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video-surveimit në përmbajtje të "Rregullores së Brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 31/a/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar:

- Në aktet e brendshme organizative, aktet që sanksionojnë marrëdhënien me punonjësit dhe aktet lidhur me rregullat e përpunimit të të dhënave personale, të parashikohet qëllimi i mbajtjes së të dhënave të punonjësve për një afat 3 vjeçar pas përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Në aktet e brendshme organizative dhe aktet që sanksionojnë marrëdhënien me klientin ("Formularin e aplikimit për kredi", "Kontratën e huasë tip" dhe

“Kontratën e Hipotekës tip”), të parashikohet qëllimi i mbajtjes së të dhënave të tyre për një afat 5 vjeçar pas përfundimit të marrëdhënies kontraktore.

2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar:

- Të realizohet informimi i klientëve dhe punonjësve (në cilësinë e subjektit të të dhënave personale) mbi të drejtat që gëzojnë në kuadër të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, nëpërmjet parashikimit të dispozitave konkrete në “Formularin e Aplikimit për Kredi”, “Kontratën e Huasë tip”, “Kontratën e Hipotekës tip” dhe Kontratën e Punës tip”;
- “Politika e privatësisë” e publikuar në faqen e internetit të kontrolluesit, duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të parashikojë dispozita për çdo kategori të dhëne personale dhe çdo subjekt të të dhënave, për të dhënat që përpunohen manualisht dhe për ato që përpunohen elektronikisht.

3. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të tregohet kujdes në vijimësi në përditësimin e “Formularit të Njoftimit” pranë Zyrës së Komisionerit.

4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i këtyre detyrimeve brenda një afati 30 ditor, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi dhe pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë, për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

BESNIK DERVISHI



KOMISIONERI